



QKLL 2025

AKTIVITETE TË QENDRËS KOMBËTARE TË LIBRIT DHE LEXIMIT

JANAR



NTAHEN ÇMIMET KOMBËTARE TË LETËRSISË PËR VITIN 2023



TAKIM ME DREJTORIN E INSTITUTIT ITALIAN TË KULTURËS Z. ALESSANDRO RUGGERA



Në një takim me drejtorin e Institutit Italian të Kulturës z. Alessandro Ruggera, u diskutua për projektet e përbashkëta për vitin 2025:

Krijimi i një Fondi të përbashkët për të mbështetur përkthyesit shqiptarë që sjellin në gjuhën shqipe autorë nga letërsia italiane, krijimi i hapësirave për rezidenca për përkthyesit, apo promovimi i veprave të autorëve të kësaj letërsie në gjuhën shqipe si dhe mbështetja ndaj botuesve ish-in në qendër të bisedës.

JURIA E ÇMIMIT "LUMO SKËNDO", THIRRJE PËR VEPRAT MË TË MIRA NË FUSHËN E PUBLICISTIKËS DHE ESEISTIKËS



Juria e Çmimit "Lumo Skëndo", në mbledhjen e radhës për të shqyrtuar veprat më të mira që garojnë për këtë vlerësim për vitin 2024.

Juria e edicionit të katërt të çmimit "Lumo Skëndo", drejtohet nga prof. Belina Budini dhe ka anëtarë z. Uran Butka, studiues i veprës së Mit'hat Frashërit, akademik Anastas Angjelin, gazetaren Rudina Xhunga dhe gazetaren Aida Tuci. Ky çmim shihet si një vlerësim për të nxjerrë në pah vlerat më të mira të botimeve në gjuhën e publicistikës dhe eseistikës që kanë një rol në diskutimet publike.

TAKIM ME SHKRIMTARIN BASHKIM HOXHA në një bisedë për botimet e tij më të fundit



TAKIM ME SHKRIMTARIN SHEFET MEKO në përrurimin e romanit të tij "Rënia"



TAKIM ME PËRKTHYESIN e Servantesit, BAJRAM KARABOLLI





QKLL 2025

JANAR



AKTIVITETE TË QENDRËS KOMBËTARE TË LIBRIT DHE LEXIMIT

Ndahen Çmimet Kombëtare të Letërsisë për vitin 2023



“ROMANI MË I MIRË I VITIT” I JEPET AUTORIT **BESNIK MUSTAJ:**

Për romanin “Fati i marrë” për guximin dhe imagjinatën në krijimin e një historie “alternative”, ku mjafton të ndryshosh një detaj të vogël në histori shekuj më parë, për të na ndihmuar të gjejmë një Shqipëri më të mirë, e mbi të gjitha, më të ndjeshme; ku heronjtë janë më të prekshëm e më njerëzorë; ku gratë flasin, qoftë dhe me gjuhën e shenjave...



“VEPRA MË E MIRË STUDIMORE E VITIT” I JEPET AUTORIT **PËLLUMB XHUFË:**

Për librin “Shqipëria dhe fundshekulli i dëshpëruar” për hulumtimin e dokumentimin e thelluar, bazuar në fakte dhe dokumente të një epoke, ku ndriçon me kompetencë ngjarjet dhe sfidat e periudhës mesjetare shqiptare, duke sjellë për të parën herë një pasqyrë të përpjekjeve të shqiptarëve për të mbijetuar si popull dhe komb në kohëra të errëta, duke ofruar një kontribut të vyer për studimet historike shqiptare.



“PËRKTHIMI MË I MIRË I VITIT” I JEPET PËRKTHYESËS **ANA KOVE:**

Për përkthimin e librit “Daulla prej llamarine” nga Gunter Grass, për punën mjeshtërore, përmes së cilës përkthyesja arrin të përçojë me rrjedhshmëri te lexuesi shqiptar thellësinë e zërit të pazakontë të personazhit dhe satirën e mprehtë të autorit.



“VËLLIMI MË I MIRË POETIK I VITIT” I JEPET AUTORES **ENTELE TABAKU:**

Për librin me poezi “Qeramikiana”, për eksplorimin mjeshtëror në poezinë e saj të brishtësisë dhe reziliencës; për mënyrën se si përvojat e saj personale filtrohen në një gjuhë poetike më të madhe se jeta, duke kapur thelbin e emocioneve njerëzore me imagjinatë të gjallë dhe thellësi të jashtëzakonshme; si dhe për pasurimin e poezisë shqipe me zërin e saj lirik unik.





QKLL 2025

JANAR




AKTIVITETE TË QENDRËS KOMBËTARE TË LIBRIT DHE LEXIMIT



“VËLLIMI MË I MIRË ME TREGIME I VITIT” I JEPET AUTORIT **SHPËTIM KELMENDI**:

Për librin “Dashnia asht”, për eksplorimin e hapësirave më intime brenda nesh; me një gegnishte kumbuese e me një ndjeshmëri të rrallë...”.



“LIBRI PËR FËMIJË MË I MIRË I VITIT” I JEPET AUTORES **LEDJONA BRAHO**:

Për librin “Kroni dhe Pulëbardhat”, për kurajën e trajtimit të temave të forta bashkëkohore”.



TAKIM ME DREJTORIN E INSTITUTIT ITALIAN TË KULTURËS

Z. ALESSANDRO RUGGERA


Në një takim me drejtorin e Institutit Italian të Kulturës z. Alessandro Ruggera, u diskutua për projektet e përbashkëta për vitin 2025:

Krijimi i një Fondi të përbashkët për të mbështetur përkthyesit shqiptarë që sjellin në gjuhën shqipe autorë nga letërsia

italiane, krijimi i hapësirave për rezidenca për përkthyesit, apo promovimi i veprave të autorëve të kësaj letërsie në gjuhën shqipe si dhe mbështetja ndaj botuesve ishin në qendër të bisedës.

Ky vit shënjon 50-vjetorin e ndarjes nga jeta të intelektualit dhe një figure të shquar të

kulturës italiane si Pier Paolo Pasolini. Bashkë me Institutin Italian të Kulturës do të nderojmë veprën dhe kontributin e tij në kulturën botërore, përmes disa aktiviteteve në të ardhmen.





QKLL 2025

JANAR



AKTIVITETE TË QENDRËS KOMBËTARE TË LIBRIT DHE LEXIMIT



TAKIM ME PËRKTHYESIN E SERVANTESIT, **BAJRAM KARABOLLI**

Ishte i ftuar në një takim në ambientet e Qendrës Kombëtare të Librit e Leximit përkthyesi i romanit “Sojliu mendjemprehtë, Don Kishoti i Mançës” nga Servantesi, Bajram Karabolli. Një përkthim i ri në shqip pas atij 100-vjeçar të Nolit, me një shqipe më të pasur, fragmente dhe faqe të tëra të përkthyer për herë të parë nga Karabolli. Ripërkthimi i këtij romani ofron një qasje dhe mundësi të re leximi dhe interpretimi për lexuesin e sotshëm. Gjatë takimit me

gjimnazistët e “Luan Hajdaragës”, Karabolli foli mbi procesin e përkthimit të romanit, njohjen e jetës dhe veprimtarisë së Servantesit, njohjen me veprën në gjuhën origjinale, përkthimet në gjuhë të tjera si dhe me përkthimet në gjuhën shqipe (Noli dhe Zheji).

Fragment nga romani:

Vëllimi i parë, Kapitulli XXX, f. 402: “Dije se nuk u takon kalorësve endacakë të zbulojnë nëse të brengosurit që hasen në rrugë, të

lidhur me zinxhirë dhe të shtypur, qenkan në atë gjendje dhe u torturuakan për shkak të gabimeve të tyre apo të meritave të tyre. Detyra e kalorësit në ato çaste është që t’i ndihmojë dhe t’i shpëtojë ata fatkëqij, sepse shikon mjerimin e tyre dhe jo gabimin e tyre. Unë takova një vargan me njerëz të ligështuar e të poshtëruar dhe bëra atë që Urdhri i Kalorësit më detyronte të bëja, pjesa tjetër nuk më intereson.”

Përktheu: Bajram Karabolli





QKLL 2025

JANAR



AKTIVITETE TË QENDRËS KOMBËTARE TË LIBRIT DHE LEXIMIT

JURIA E ÇMIMIT “LUMO SKËNDO”, THIRRJE PËR VEPRAT MË TË MIRA NË FUSHËN E PUBLICISTIKËS DHE ESEISTIKËS

Juria e Çmimit “Lumo Skëndo”, në mbledhjen e radhës për të shqyrtuar veprat më të mira që garojnë për këtë vlerësim për vitin 2024.


Juria e edicionit të katërt të çmimit “Lumo Skëndo”, drejtohet nga prof. Belina Budini dhe ka anëtarë z. Uran Butka, studiues i veprës së Mit’hat Frashërit, akademik Anastas Angjelin, gazetaren Rudina Xhunga dhe gazetaren Aida Tuci.

Ky çmim shihet si një vlerësim për të nxjerrë në pah vlerat më të mira të botimeve në gjininë e publicistikës dhe eseistikës që kanë një rol në diskutimet publike.

Ftojme botuesit dhe autorët të dorëzojnë vepra në këto dy gjini të botuara gjatë këtij viti, pranë Qendrës Kombëtare të Librit dhe Leximit.



TAKIM ME SHKRIMTARIN SHEFQET MEKO NË PËRURIMIN E ROMANIT TË TIJ “RËNIA”



Hapësira e Qendrës Kombëtare të Librit dhe Leximit mirëpriti promovimin e romanit “Rënia” të shkrimtarit Shefqet Meko. Pjesëmarrësit e shumtë e vlerësuan krijimin e Mekos, që me kulturë përshkruan periudhën e ndryshimit epokal të regjimeve, nga ai komunist, në demokracinë e ditëve të para. Botuesi i “Mediaprint” falënderoi autorin që e përzgjodhi për këtë botim të spikatur. Të pranishmit që morën fjalën, Ahmet Premçi, Marash Mirashi, Arben Çeku, prof. Xhevat Lloshi, por dhe Agim Baçi e Behar Gjoka e zbërthyen përmbajtësisht dhe teorikisht esencën e romanit “Rënia”, të cilin e vlerësuan edhe si autobiografik (të fshehur). Atë e quajtën edhe roman kujtesë, një pasqyrë të situatave të kohës dhe personazhit kryesor. U fol në takim edhe rreth përjetimeve nga leximi, si dhe nga ngjarjet me Shefqet Mekos. Ky i fundit, pas falënderimeve, theksoi se romani i tij mishëron dëshirën për të pasqyruar realisht, ngjarjet e kaluara në kapërcyell të epokave.



QKLL 2025

JANAR



AKTIVITETE TË QENDRËS KOMBËTARE TË LIBRIT DHE LEXIMIT

ME SHKRIMTARIN BASHKIM HOXHA NË NJË BISEDË PËR BOTIMET E TIJ MË TË FUNDIT



“Post scriptum” titullohet krijimi më i ri i Bashkim Hoxhës, i cili u promovua në Qendrën Kombëtare të Librit dhe Leximit. Pjesëmarrës në këtë aktivitet vlerësuan librin, të cilin autori e ka quajtur rrëfim, një zhanër që afron disi me

romanin. Vepra është përjetim i marrëdhënieve të autorit Bashkim Hoxha me shumë artistë e figura të njohura, realisht. Është shumë i madh dhe i larmishëm numri i personazheve e në libër, që janë emra realë, ashtu si dhe rrëfimtari në vetë të parë. Hoxha flet në libër, për fillesat tija në

botën e letrave, deri dhe në ditët e sotme. Rrëfimtari nuk ka interpretuar realitetin dhe siç tha, nuk ka dashur as ta letrarizojë realitetin. Në aktivitet u përvurua



edhe romani tjetër i Bashkim Hoxhës “Koncert në ditën e gomarit”, të cilit iu kushtuan pak fjalë dhe vlerësime nga pjesëmarrësit.

